



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 15 datë 30/12/1996

**PER
NDERRIM EMRI OSE MBIEMRI.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, në mbledhjen e tij të dt.30.12.1996, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Gjendjes Civile “Për ndërrim Emri ose Mbiemri”, sipas kërkesave të qytetarëve, në mbështetje të Ligjit Nr.5840, neni.21, dt.20.02.1979, i ndryshuar me ligjin Nr.7682, dt.09.03.1993 “Për rregjistrimin e akteve të gjendjes civile” :

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e emrave ose të mbiemrave sipas disa kriterëve :
 - 1.Emrat ose Mbiemrat që ndryshojnë me një gërmë.
 - 2.Mbiemri i vajzërisë ose i bashkëshortit(seksi femër).
 - 3.Emrat – Mbiemrat përçmues.
 - 4.Emrat – Mbiemrat kur ka vendim gjyqi, kur ka dokumentacion zyrtar – administrativ.
 - 5.Kur janë fëmijë të birësuar.
 - 6.Uniformiteti i Mbiemrit në familje.
 - 7.Për interesa të rëndësishme.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI